




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, eeegjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e tretë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 31.1. 2014 me këtë:

REND TË PUNËS

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2 Propozim vendimi për miratimin e iniciativës së kryetarit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Gjilanit,
- 3 Raporti financiar Korrik-Shtator 2013,
- 4 Raporti financiar Tetor-Dhjetor 2013,

Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.5 m

Kryesuesja e Kuvendit
Valentinë Bunjaku- Rexhepi

Në punimet e seancës së tretë morën pjesë:
Anëtarët e Kuvendit,
Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesi i OSB-së, z. Basri Sejdiu
Përfaqësuesi për të Drejtat e Njeriut Fazli Abdullahu
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu
Përfaqësuesi i KVRL-së
Mediet

Punimet e seancës së tretë i hapi dhe i kryesoi kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentinë Bunjaku- Rexhepi e cila e përshëndeti kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, anëtarët e Kuvendit, përfaqësuesit e OSB-së si dhe nënkryetarin e Komunës, z. Rexhep Kadriun si dhe të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët ishin të pranishëm në punimet e seancës së tretë. Në vijim të fjalës së saj kryesuesja e Kuvendit zonja Bunjaku theksoi se të gjithë

anëtarët e Kuvendit e kanë marrë materialin për këtë seancë të cilin material e keni analizuar, por ne jemi takuar edhe me shefat e grupeve kuvendare dhe në parim jemi pajtuar me këto pika të rendit të punës, kurse fillimisht kërkoi nga sekretari që të verifikojë prezencën e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Pas ftesës që i bëri sekretari anëtarëve të Kuvendit, u konstatua se në punimet e kësaj seance ishin të pranishëm 34 anëtarë të Kuvendit, kurse mungoi: një (1);
Arijetë Rexhepi

Abdyl Aliu- të gjithë ata të cilët i ka përshëndetur Valentina i ka përshëndetur edhe në emër timin, por unë dua t'iu njoftoj se rritja e LDK-së po vazhdon dhe me këto rritje LDK po forcohet dhe sa më e fortë LDK, aq më e fortë janë edhe shpresat tona këtu, por edhe të qytetarëve të Gjilanit për jetësim të programit tonë.

Më lejoni ta paraqes një dimension të ri të grupit kuvendar të LDK-së, sepse në KK të Gjilanit, LDK aktualisht i ka 13 anëtarë të Kuvendit. Jemi të nderuar se në grupin e anëtarëve të LDK-së është bashkuar edhe Selver Xhelili nga Lëvizja Republikane, por edhe Mizafere Ismaili nga AKR-ja iu është bashkuar grupit të LDK-së.

Gjithashtu në emër të grupit të LDK-së e përgëzojë koalicionin e arritur në mes AAK-së dhe LDK-së me të cilin koalicion është bërë një punë e mirë dhe kjo është bërë për një funksionim sa më të mirë të Kuvendit të cilit Kuvend i dëshiroj punë të mbarë.

Arben Maliqi- i nderuari kryetari i Komunës, ju anëtarë të Kuvendit, media dhe të gjithë të tjerët, unë fillimisht po i shprehi ngushëllime të thella me rastin e vdekjes tragjike të koleges sonë nga radhët e AKR-së në Gjakovë, zonjës Zarushe. Kjo është një humbje e madhe për të gjithë ne, sepse ka qenë një person me vlera dhe kualitete intelektuale dhe morale.

Gjithashtu zonjës Ismaili i uroj sukses dhe shëndet dhe punë të mbarë me rastin e aderimit në LDK. Unë e përshëndes këtë zonjë, sepse ka dhënë një kontribut në AKR, prandaj e përshëndes dhe i uroj suksese.

Zijanin Maliqi- pasi që jemi te rendi i punës, unë propozoj që të bëjmë ndryshime në rend të punës (te pika 3 dhe 4), gjegjësisht te raportet financiare.

Këto raporte propozoj që të jenë vetëm si informata për arsye se tre mujori i tretë është i vonuar shumë dhe nuk ka asnjë efekt që tash të diskutohet ky raport. Ligji mbi menaxhim të financave e thekson se më së largu 30 ditë nga përfundimi i raportit të fundit të debatohet. Unë propozoj që këto dy pika të jenë si një pikë dhe të jenë si informata.

Të debatohet për këto, por të mos votohen, sepse as ligji nuk e lejon, por edhe janë shumë të vonuara.

Miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Fehmi Sylejmani- kur është fjala për procedurën e votimit për kryesuesen e Kuvendit, thuhet se në kuti të votimit ishin 27 fletëvotime, 4 të pavlefshme, 11 abstenime dhe 23 për, është bërë një gabim teknik, sepse matematikisht nuk është në rregull, sepse Kuvendi i ka 35 anëtarë, prandaj në bazë të këtyre shifrave na dalin më tepër, prandaj duhet të jetë 8 abstenime dhe jo 11.

Vërejta e dytë është se unë kam kërkuar që nga seancat e sotme të bëhet incizimi i çdo seance dhe të publikohet në Web slajd të faqes zyrtare dhe jo në TV dhe radio lokale, sepse unë e di që kjo bëhet në TV dhe radio lokale.
Të jetë në ueb saj (në faqen zyrtare të Komunës).

Gjithashtu herëve të tjera kryesuesja iniciativat duhet t' i hedhë në votim, kurse Kuvendi i miraton ose nuk i miraton.

Mandej për pikën 2 të rendit të punës fillimisht ka qenë desh të diskutohet në KPF, kurse pastaj të procedohet në Kuvend për shqyrtim dhe nëse është e arsyeshme edhe të miratohet.

Mandej në këtë propozim –vendim të pikës 2 të rendit të punës nuk mund të nxirret ndonjë konkludim se cilat janë arsyet e kësaj iniciative të kryetarit të Komunës (i tërhiqet vërejtja nga kryesuesja se në rend të punës është miratimi i procesverbalit).

Riad Rashiti- unë kam një pyetje se a ka të drejtë që një këshilltar komunal t' i ketë dy pozita. Një pozitë të anëtarit të Kuvendit dhe një të drejtorit apo zv/ drejtorit?

Valentinë Rexhepi Bunjaku - duhet të vazhdojmë me rend të punës, kurse lidhur me këtë pyetje kemi kërkuar interpretim ligjor, nga MPL-ja.

Valentinë Rexhepi – Bunjaku – të deklaroheni se kush është për aprovim të procesverbalit me vërejtjet e z. Sylejmani.

Aprovohet procesverbali me vërejtjet e z. Sylejmani me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

2. Propozim vendimi për miratimin e iniciativës së kryetarit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Gjilanit

Sahit Abazi- ne pajtohemi me këtë rend të punës në përgjithësi, sepse një pjesë e është formale, por pajtohemi edhe me propozimin e z. Maliqi që pika 3 dhe 4 të jetë një pikë dhe të mos quhet raport, sepse nuk është e obliguar Drejtoria e Financave të sjell raport për këtë periudhë, por duhet të sjellë vetëm informatë.

Pika dy e rendit të punës ne dhe në seancën e kaluar kemi kërkuar që të shtyhet kjo pikë e rendit të punës. Ne në parim nuk jemi kundër nismës së kryetarit të Komunës për ndryshim të Statutit, sepse kryetarit ndoshta i duhet një riorganizim edhe i Komunës dhe i drejtorive, mirëpo neve na mungojnë edhe në këtë seancë informatat për këto ndryshime që planifikohen të bëhen. Përsëri në materialin që e kemi nuk ka sqarime të tjera më tepër se ato që i kemi pasur në seancën e kaluar.

Ne nuk e dimë në vija të trasha se çka do të ndodh me këto ndryshime dhe ne nuk mund të jemi për këtë nismë, sepse nuk i kemi këto informata së paku në vija të trasha.

Për pikën nën të ndryshme kërkojmë informatë nga drejtori i Arsimit që të na informojnë për incidentin që ka ndodhur në Gjimnaz. Kërkesë tjetër është që të shikohet edhe mundësia e transmetimit të drejtpërdrejtë të seancave në TV “Vali”.

Mandej kërkojmë një informatë nga kryetari i Komunës për shërbyesit civil të cilëve sot iu ndërpritet kontrata e të cilët kanë qenë me kontrata në vepër. Kërkojmë për ta ditur se çka do të ndodh me ata shërbyes ? Ne po e informojmë kryetarin e Komunës se në mesin e tyre ka profesionist të mirë, punëtorë të mirë, por ka edhe fëmijë të familjeve të

Dëshmorëve. Pyetja është se çka do të ndodh me këta punëtorë të cilët kanë qenë shërbyes civil në Komunë deri më sot?

Një vërejtje për sekretarinë e Kuvendit, sepse anëtarët e PDK-së nuk kanë pasur ftesa për “Flakën e Janarit”, prandaj kërkojmë ta dimë pse ka ndodhur kjo?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- kush është që të aprovohet rendi i punës me këto plotësime?

Aprovohet rendi i punës me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi - pika e dytë e rendit të punës në parim është votuar, por sqarime më detale do të jep kryetari i Komunës.

Lutfi Haziri- e nderuara zonja kryesuese, drejtorë, anëtarë të Kuvendit jam i kënaqur sot që para se ta arsyetoj qëndrimin për ndryshimin e Statutit, arrijten e marrëveshjes politike për qeverisjen me qytetare e cila është realizuar me grupin politik të AAK-së, me PSD-në, PD-në dhe Partinë Demokratike Turke. Ne do të fillojmë angazhimet edhe me të gjithë ata që janë të interesuar për një stabilitet institucional në Komunën tonë.

Ne do të jemi të hapur që të punojmë në të mirë të Gjilanit edhe me opozitën edhe me të gjithë përfaqësuesit e qytetarëve të cilët aktualisht kanë mandat, politik dhe legjimitet.

Arsyeja e parë bazë në të cilën unë jam thirrë është ndryshimi i ulëseve në Asamble Komunale. Gjilani sipas Statutit të Komunës i ka 41 ulëse, por si pasojë e censuesit, MPL-ja në riorganizimin dhe referimin e numrave të rinj ka vendos që Gjilani të jetë në kategorinë e komunave që t’i ketë 35 anëtarë të Kuvendit dhe kjo është baza themelore në të cilën unë jam thirrë dhe e cila duhet të ndryshohet.

Mirëpo mundësia e ndryshimit të Statutit është e hapur, është legjitime dhe duhet të ndodh edhe për arsye që shefi i grupit nga radhët e PDK-së i tha, për shkak të mbingarkimit të punëtorëve jashtë ligjit. Për shkak të ofrimit të shërbimeve profesionale dhe pagesës së punëtorëve duke ia paguar TVSH-në dhe duke mos ia paguar fondin pensional. Për shkak të mbingarkesave të strukturës dhe organizmit si staf, sepse si staf njëherë e përgjithmonë duhet të vendoset në parametra që të gjithë këshilltarët dhe të gjithë drejtorët dhe të gjithë përfaqësuesit e Komunës duhet ta respektojnë. Ne duke i identifikuar 27 probleme të cilat janë specifikuar dhe arsyet tjera Statuti i Komunës duhet të ndryshohet dhe duhet të ndryshohet në bashkëpunim me të gjitha forcat politike.

Ne do t’i emërojmë edhe tre profesionistë, tre juristë nga shërbimi civil e që do të jenë pjesë e punës në mënyrë që anëtarët e Kuvendit ta precizojnë dhe saktësojnë dhe në mënyrë eksplicite, t’i sqarojnë disa nga funksionet e KK-së dhe disa nga përgjegjësitë e zyrtarëve komunal. Këto janë arsyet kryesore, por nëse pajtohemi ne në Statut e përcaktojmë edhe privilegjet dhe kategorinë e Familjeve të Dëshmorëve. Mirëpo për ta mbajtur një anëtarë të Familjes së Dëshmorëve me kontratë në vepër më shumë se 4 vjet është mashtrim dhe kjo e humb legjimitetin.

Nuk ka të drejtë askush ta mbajë punëtorin me kontratë në vepër. Dihet se çka thotë ligji për të gjithë ata që duan të kenë kontratë në vepër dhe për të gjithë ata që duan të kenë shërbime profesionale. Unë iu ftoj që të thirremi në arsye dhe nuk dëshiroj që të merrem me të kaluarën.

Ju falënderoj që u solidarizuat edhe me raportin financiar, por ligji ka kërkuar që çdo tre mujor kryetari i Komunës përmes Drejtorisë së Financave të paraqet raportin financiar.

Unë iu kam referuar ligjit dhe tremujorët e dytë i ka sjellë këtu, por nuk barti përgjegjësi për shpenzimet. Unë e kam proceduar për t’i përmbush obligimet ligjore që kryetari i

Komunës i ka pasur e që duhet t' i realizojmë gjatë tërë kohës dhe gjithçka do të jetë në tavolinë dhe gjithçka do të vendoset këtu.

Nevzad Isufi- i përshëndes të gjithë dhe i uroj punë të mbarë të gjithëve në këtë seancë!

Lidhur me pikën dy, ne edhe herën e kaluar kemi thënë se duhet të precizohet se çka pretendohet të ndryshohet? Me përjashtim të nenit 46 alinea 3 ku dihet në bazë të ligjit të LVL- së ndryshon numri i ulësve në Kuvend, besoj që ajo nuk është diskutabile për askënd. Mirëpo ne kërkojmë një precizim të gjërave të cilat duhet të ndryshohen.

Mandej brenda dy mandateve dy herë është ndryshuar Statuti më 2008 dhe 2011, por që në esencë dhe përmbajtje nuk ka ndonjë ndryshim. Nëse mendohet dhe ashtu është se Statuti është një akt nënligjor ose Kushtetutë e Komunës, atëherë nuk duhet të insistojmë që çdoherë ta ndryshojmë këtë statut sa herë që vije një parti në pushtet, sepse çdo herë do të kishim, tendencë për ta ndryshuar. Mendoj se statuti duhet të jetë një dokument i cili mund të ndryshohet vetëm me përmbajtje konkrete, por jo gjithmonë të ketë synime për ndryshime. Mendoj se duhet precizuar se cila pjesë e statutit duhet të ndryshohet dhe jo të thuhet gjërat në mënyrë të përgjithësuar.

Ashtu si po thuhet ne vetëm do të humbim kohë duke u marrë me çështje të planifikimeve të reja, formimit të komiteteve etj.

Abdyl Aliu- neni 12 i LVL-së, flet për aktet e KK-së, të cilin nen z. Aliu e lexon i cili në vazhdim thekson se Kurani dhe Bibla e LDK-së është programi të cilin e kemi shpalos para elektoratit në këto zgjedhjet e fundit. Karshi këtij programi të cilin e kanë përfaqësuar shumica, ne e kemi hap edhe rrugën të cilën do ta ndjekim për realizimin e këtij programi, kurse kjo rrugë i bie edhe në drejtim të Statutit të Komunës dhe për këtë arsyeje kryetari e ka marrë këtë iniciativë.

Ndryshimi dhe plotësimi i statutit do ta lehtësojë punën për neve të gjithë dhe do të ketë për rrjedhojë realizimin e synimeve që kanë të bëjnë me rritje të efikasitetit të punës në administratë të Komunës. Unë i ftoj të gjitha grupimet politike dhe të gjithë këshilltarët veç e veç që ta kenë qëllimin e mirë të kësaj iniciative dhe ta mbështesin këtë iniciativë. Ne i kemi emrat për komision statutar, kurse tash kërkojmë edhe nga subjektet tjera që t' i sjellin e emrat e këtij komisioni i cili komision do të bëjë draftin e ndryshimeve të Statutit.

Selami Xhemajli- përshëndetje për kryetarin, zv/kryetarin dhe për të gjithë kolegët dhe të pranishmit e tjerë në këtë seancë. Ne si grup politik i AAK-së e përkrahim iniciativën e kryetarit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës, duke i pasur parasysh arsyetimet të cilat i dha kryetari, mirëpo edhe ato çka janë obligim i ynë ligjor për harmonizimin ose përshtatjen e statutit i cili është dokument më i ulët se LVL-ja.

Në ne nenin 36 të LVL-së është përcaktuar numri i anëtarëve të këtij Kuvendit në bazë të regjistrimit të fundit të banorëve që i ka Komuna e jonë. Ne obligim ligjor e kemi që ta harmonizojmë statutin, por edhe të gjitha arsyetimet që i dha kryetari i Komunës ne i përkrahim në mënyrë që ne si Kuvend t' i mundësojmë ekzekutivit dhe kryetarit për ta pasur komplet infrastrukturën ligjore për ta pasur një administratë funksionale dhe efikase. Në fund unë kërkoj vetëm një sqarim të propozim-vendimi, sepse ne e kemi formuar komisionin për këtë qëllim, por në pikën tre të arsyetimit të kryetarit thuhet: “ komisioni i cili formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit”. Kërkoj sqarime a është fjala për komision statutar, apo është fjala për një komision tjetër profesionistë i cili do të jetë si ndihmë e këtij komisioni ?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – do të jetë komisioni i njëjtë, sepse ky komision është formuar në seancën e kaluar i cili komision i ka 5 anëtarë.

Izmi Zeka- unë kërkoj nga Zyra Ligjore që të jep interpretime se a ka të drejtë që të vijë në Kuvend iniciativa për ndryshim të Statutit për pa kaluar në KPF? Unë besoj se Zyra Ligjore e ka të qartë, prandaj nuk është mirë që nga fillimi i këtij mandati të shkelen procedurat! Kjo është aspekt procedural dhe mos e përmendini shumë statutin, sepse ka të qartë edhe LDK dhe të gjithë të tjerët se LVL i rregullon të gjitha gjërat dhe nuk është Statuti i cili e rregullon organizmin e brendshëm, efikasitetin, fleksibilitetin e Komunës dhe programin e LDK-së se çka ka planifikuar. Është e drejtë e juaja mund ta ndryshoni edhe statutin, por vetëm respektoni procedurat. Ne nuk jemi për këtë mënyrë të punës qysh në start për pa i respektuar procedurat.

Ne nuk jemi për të penguar punën, por së pari të shqyrtohet kjo çështje në KPF, pastaj e sillni këtu, por edhe të keni konsideratë, sepse iniciativën mund ta sjell edhe kryetari, por zakonisht kjo bëhet në emër të KK-së.

Edhe njëherë po e theksoj se të na jep sqarime Zyra Ligjore sa a ka të drejtë KK të merr këtë iniciativë për pa kaluar në KPF, të na sqarohet kjo, mandej ne po e mbështesim?

Riad Rashiti- unë do të dal pak jashtë rendit të ditës, por do të ndërlidhem me fjalën e kryetarit i cili i dha disa sqarime më herët dhe kërkojmë nga kryetari që në seancën e radhës t' i sjell me shkrim 27 probleme të cilat i ka identifikuar të cilat është mirë t' i kemi dhe t' i dimë. Sa i përket punësimeve të jashtëligjshme që u thanë unë mendoj se grupi i LDK-së gjatë mandatit sa ka qenë në opozitë ka qenë mjaft aktiv dhe është marrë me rastet të cilat kanë dyshuar se janë të jashtëligjshme dhe i ka procesuar për vlerësim për t' i vërtetuar a janë apo jo të jashtëligjshme. Unë mendoj se nuk ka pasur punësime të jashtëligjshme, por ka qenë nevoja në Komunë të Gjilanit për rritje të shërbimeve dhe rritjen e vëllimit të punëve. Mendoj se ka qenë nevojë për Komunën dhe mendoj se kryetari i Komunës nuk duhet dhe nuk mund t' i ik nevojave me të cilat do të ballafaqoheni në qeverisjen katër vjeçare.

Sa i përket pagesës së punëtorëve, mendoj se është keqkuptim ose diçka nuk është në rregull, sepse ata punëtorë që janë të angazhuar në punë në Komunë të Gjilanit nuk ka qenë e mundur që t' i paguhet TVSH-ja dhe mos i paguhet trusti pensional edhe për ata që kanë qenë të punësuar në mënyrë të përkohshme.

Punëtorët të cilët kanë qenë të kontraktuar përmes firmës ose biznesit, ka qenë i obliguar biznesi përkatës t' ia paguaj trustin pensional, por jo Komuna e Gjilanit.

Arben Maliqi- në këtë qeverisje janë bërë disa ndryshime, janë bërë disa koalicione të cilat i përshëndes dhe i uroj punë të mbarë! Sa i përket komisionit statutar dhe akteve tjera normative unë kërkoj që ky komision të jetë gjithëpërfshirës i cili luan një rol relevant dhe është i rëndësishëm së madhe, prandaj mendoj se duhet të zgjerohet, sepse me sa di unë në këtë komision kanë qenë 15 anëtarë dhe mendoj se 5 anëtarë në komision na del një komision i ngushtë. Mendoj se duhet ta kemi një koncenzues dhe duhet të jetë nga secila parti nga një anëtarë.

Sa i përket Statutit është mirë që nga kryetari i Komunës apo dikush tjetër që të specifikohen se cilat janë ato ndryshime të cilat do të bëhen, sepse ne jemi ata të cilët e përcaktojmë numrin e drejtorive, kurse kryetari e ka të drejtën që t' i emërojë drejtorët.

Është mirë që të specifikohen këto gjëra dhe të ecim tutje. Edhe unë jam që ta aprovojme këtë iniciativë, por është mirë që të bëhet ky specifikim.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi – komisioni do të jetë prej 5 anëtarëve, kurse kryetari i Komunës do ta formojë një komision tjetër profesional nga shërbyesit civil i cili komision do të vijë në Kuvend dhe të jep sqarime.

Arben Maliqi- unë kërkoj që të jetë edhe nga një anëtarë në këtë komision edhe nga subjektet e tjera dhe kërkoj që të hedhet në votim ky propozim.

Izmi Zeka- unë edhe njëherë po kërkoj përgjigje nga Zyra Ligjore.

Lutfi Haziri- për shkak të respektit ndaj jush unë gjithmonë do të flas para jush gjithmonë prej kësaj foltoreje. Nëse dikush kërkon përgjigje prej zyrtarëve të Komunës këtë mund ta bëjë me shkrim edhe atë jashtë seancës. Komunikimi në mes të zgjedhurve duhet të bëhet drejtpërdrejtë dhe nuk kemi nevojë të fshehemi pas askujt, por e dyta iniciativa nuk pengohet dhe nuk lidhet ngushtë me ndryshimin. Unë ka marrë iniciativë dhe nuk jemi duke kërkuar ndryshim. KPF do të jetë ai i cili e procedon në shkallën e parë para se të vijë këtu ndryshimi dhe nëse nuk votohet në 2/3, atëherë statuti mbetet dhe nuk ndryshon asgjë.

Tejkalimi i stafit, struktura stërmadhe, koncentrimi i pushtetit, varshmëria e plotë e organeve nën nivelin e kryetarit të Komunës janë një nga disa probleme të cilat duhet t' i përmendim. P.sh. kryetari i Komunës ka të drejtë të jep subvencione të cilat sipas propozimeve kalojnë në procedurë, për 6 vjet asnjë subvencion financiar nuk është mbyllur në Komunë të Gjilanit, duhet saktësuar eksplicit në dokument që gjithçka nga buxheti dhe mënyra e vendimmarrjes duhet të mbyllet sipas ligjit.

Nuk po flasim për mjete të vogla, por po flasim për mjete të mëdha si p.sh varshmëria institucionale në një ekzekutiv të kulturës. Unë mendoj se duhet të organizohet kultura në mënyrë më të mirë dhe duhet rregulluar me statut. Kultura nuk duhet të jetë e varur me kryetarin e Komunës, politikat kulturore duhet të dekoncentrohen prej Komunës dhe duhet të pavarësohet prej ndikimeve politike.

Do të vijmë tek numri gradualisht dhe do t' i shihni gradualisht ato probleme, por unë iu ftoj që të bashkëpunojmë, sepse statuti është akti më i lartë i cili e rregullon mënyrën e funksionimit të Komunës. Nuk kam pretendime që tash është ndryshuar qeverisja dhe duhet të ndryshohen edhe aktet normative, por duhet të identifikohen defektet e gjetura në këto 6 vitet e fundit ose nëse dëshironi mund të themi në këto 14 vitet e fundit, kjo është e njëjtë. Në statut do të bëhen ndryshime në ato gjëra që janë ligjore, parimore dhe ato gjëra që do të kenë mirëkuptim dhe ku mund të arrihet një koncenzues. Nëse nuk mund të arrijmë koncenzues, unë në asnjë mënyrë nuk jam për ta thyer koncenzuesin. Te struktura e komiteteve do të ketë ndryshime, do të bëhet reduktimi i komiteteve, sepse nuk ka buxhet. Kjo komunë është në dietë buxhetore, kjo Komunë ka hyrë në servisim dhe është në bartje të borxheve dhe nuk mundet kjo Komunë t' i përballojë një numri aq të madh të komiteteve, prandaj duhet të bëhet një riorganizimi dhe do të bëhet një komitet i ri i cili do të merret me të drejta ekskluzive civile të shqiptarëve nga Medvegja, Presheva dhe Bujanoci.

Nëse unë e them se janë 8 milion euro borxh, kurse dikush e thotë jo nuk janë, por janë 6, atëherë dallimi është dy milion euro, por borxhe ka. Këto borxhe do të vijnë në Kuvend për secilin këshilltarë dhe qytetarë e të cilat do të zbardhen deri në fund, por detyra e jonë është të merremi me servisim, sepse nuk mund të veprojmë ndryshe.

Nuk mund të vazhdojmë për ta rrit numrin e punëtorëve, sepse i kemi fituar zgjedhjet dhe të rrisim koston buxhetore, por përkundrazi më ka qëlluar mandati për të ul shpenzime, për të bërë disiplinë buxhetore, për ta reduktuar staf, komitete, drejtori. Nëse dëshirojmë me teori të bëjmë gara, mendoj se KK ka një milion probleme para problemit të teorive.

Sahit Abazi- e para kryetari e përmendi një komitet për Luginë të Preshevës i cili normalisht do të përkrahet edhe nga PDK, sepse edhe ashtu ka qenë qëndrim në fund të mandatit të PDK-së që të themelohet ai komitet.

Sa i përket asaj që e tha kryetari ka qenë desh të dëgjohet me vëmendje kërkesa e dy këshilltarëve të PDK-së. Kërkesa e Riadit ishte që 27 problemet e identifikuar të vijnë me shkrim dhe besoj që kryetari në seancën e radhës do të na i sjell ato 27 probleme me shkrim.

E dyta ishte një kërkesë shumë legjitime e z. Zeka për të dhënë përgjigje Zyra Ligjore, këtu nuk kemi as shkelje as tejkalime.

Ne përsëri po i themi kryetarit se nuk do të pengojmë në ndryshimin e statutit, por gjithmonë do të kërkojmë sqarime shtesë dhe jo në detaje, por sqarime në vija të trash se cilat janë ato ndryshime kryesore si : numri i drejtorive, numri i komiteteve etj.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- kush është për aprovim të pikës 2 të rendit të punës?

Aprovohet pika dy e rendit të punës: Propozim vendimi për miratimin e iniciativës së kryetarit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Gjilanit, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi – u kërkua nën të ndryshme një përgjigje nga drejtori i Arsimit lidhur me një incident në Gjimnaz, por pasi që drejtori në agjendën e tij e ka një takim të rëndësishëm iu lus që të keni mirëkuptim dhe t’ia mundësojmë që të përgjigjet në pyetjen që e bëri grupi kuvendar i PDK-së.

Nazmi Musa- përshëndetje për kryetarin, zv/kryetarin dhe ju anëtarë të Kuvendit dhe të gjithë të pranishëm të tjerë në këtë sallë!

I nderuari kryetar i grupit kuvendar të PDK-së. z. Abazi, do të kërkoj nga të gjithë ata të cilët kërkojnë ndonjë përgjigje ose bëjnë ndonjë pyetje lidhur me arsimin, që paraprakisht t’i deponojnë pyetje me shkrim në mënyrë që të bëhet një përgatitje dhe përgjigja të jetë sa më e saktë.

Kryetari i përmendi 27 probleme dhe këto probleme e kanë bazën te vendimet e padrejta të cilat kanë ndodhur më herët do të thotë që nga muaji shtator. Incidenti që ka lindur në mes profesor Venhar Hazirit dhe Murat Morinës i cili e ka bazën kryesisht në muajin shtator i cili incident ka të bëjë me ndarjen e orëve mësimore të gjuhës frënge.

Sipas praktikave në shkolla, ata që kanë punuar në shkolla dhe sipas kriterëve që janë ndarë orët gjithmonë ka qenë që orët e para, numrin e orëve i ka marrë arsimtari i cili ka pasur përvojë më shumë në atë shkollë. Z. Venhari i ka bërë kërkesë Inspektorit Regjional sipas kësaj të drejte, kurse Inspektori i Arsimit i ka dhënë të drejtën që profesor Venhari ka të drejtë parësore që ai t’i merr orët e para pastaj të tjerët. Pasi që është gjysmë vjetori i parë ka pasur mirëkuptim në mes këtyre mësimdhënësve për t’i ndarë orët bashkërisht, por kanë pasur mosmarrëveshje se kush duhet të shkojë në Zhegër, në të cilën paralele njëri ka qenë desh të shkojë një ditë, kurse tjetri dy ditë. Kjo marrëveshje nuk është arritur dhe kështu ka lindur një konflikt verbal në mes të Venharit dhe Muratit, por kjo nuk ka qenë rrahje dhe grushtime siç thuhet në mjetet e informimit.

Kjo ka qenë një fjalosje një debat verbal dhe nuk është lejuar nga ana e drejtorit i cili ka qenë prezent në atë rast që të vijë deri në kacafytje ose grushtime siç është thënë.

Për këtë rast janë zhvilluar procedurat nga drejtori i shkollës, janë marrë iniciativat për stabilizimin e marrëdhënieve, kurse prof. Venharit iu ka shqiptuar një vërejtjeje.

Nga ana e prof. Venharit e kemi një ankesë, sepse i duket e padrejtë ajo vërejtje e cila iu ka bërë si qortim apo vërejtje e fundit. Kjo është përgjigja e ime për këtë rast.

3. Raporti financiar Korrik-Shtator 2013,

4. Raporti financiar Tetor-Dhjetor 2013,

Valentinë Bunjaku-Rexhepi – ne morëm qëndrim që këto dy pika të jenë një pikë dhe të jetë vetëm informatë dhe jo raport. Për këtë informatë sqarime do të na jep drejtori për Financa, z. Ilimi Limani.

Ilimi Limani – sipas Ligjit mbi financat publike neni 45, kryetari i Komunës është i obliguar që pas çdo tre mujori të përgatis një raport tre mujor për anëtarët e Kuvendit.

Drejtorja për Buxhet dhe Financa qysh në muajin tetor e ka përgatitur këtë raport (tre mujorin e tretë) me kohë, por për shkak se nuk ka pasur seanca për shkak të fushatës zgjedhore nuk ka pasur mundësi të paraqitet raporti.

Pajtohem që sot të jetë një informatë, sepse neni 46 i Ligjit mbi financa publike thotë se deri më 31 mars kryetari i Komunës është i obliguar të jap një raport të detajuar. Unë në këtë informatë si po quhet e kam vetëm një sqarime se të hyrat dhe shpenzimet në raporte financiare paraqiten në momentin e ndodhjes në Bankën Qendrore (në thesar pagesat të hyrat apo shpenzimet).

Në vijim të fjalës së tij z. Limani dhe edhe sqarime tjera lidhur me këtë informatë të cilën anëtarët e Kuvendit e kanë marrë së bashku me materialin.

Nevzad Isufi- edhe unë pajtohem dhe ishte propozim i mirë nga ana e Zijadin Maliqit i cili propozoi që ky raport të jetë një pikë dhe të quhet informatë. Mirëpo dallon në përmbajtje, sepse nëse në tre mujorin e parë mund të bëhet informatë dhe nuk mund t' i drejtohem askujt, shtrohet pyetja a dallon në këtë aspekt tre mujori i dytë. Në anën tjetër më duket se është në rregull, sepse Kuvendi ka mbajtur disa seanca dhe Kuvendi ka qenë desh që për tre mujorin e parë të epet një raport, dhe pajtohem se për tre mujorin e dytë nuk ka pasur kohë.

Ne nëse nuk nxjerrim mësim dhe nëse nuk diskutojmë dhe nuk shtrojmë asnjë përgjegjësi për këtë buxhet, atëherë shtrohet pyetje cila është arsyeja e diskutimit?

Unë kam vërejtje se ka nevojë në këto raporte për sqarime për periudhën 6 mujore, sepse buxheti është ai cili na përcakton se sa mund të punojmë dhe çfarë kualiteti të punës do të kemi?

Unë po ndalem vetëm te dy çështje të cilat shihen shumë mirë si janë dallimet në harxhime në mes tre mujorit parë dhe atij të dytë. Te shpenzimet kapitale te tre mujori tretë është mbi 356 mijë €, kurse tre mujori i fundit është 2 milion 319 mijë €, është një dallim i madh për 6 herë më shumë se në tre mujorin e tretë, kurse të gjithë e dimë se çka është bërë në tre mujorin e fundit. Këto janë dilema të cilat duhet shtruar dhe nëse ka ndonjë përgjigje prej përgjegjësve përkatës ose të krijohet një komision për t' i vërtetuar se si kanë ndodhur këto dallime aq të mëdha?

A ka mundësi të jap dikush ndonjë përgjigje, apo kjo pikë është sa për të plotësuar një aspekt ligjor.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- kjo është vetëm një informatë, sepse seancë nuk ka pasur që nga muaji tetor 2013.

Zijadin Maliqi- unë që në fillim e thash se raporti i tre mujorit të tretë është i vonuar dhe

nuk e thash se është fajtor dikush, por vonesa është bërë për shkak të mos mbajtjes së seancave. Raporti i fundit është brenda afatit ligjor, sepse sot jemi në ditën e fundit të muajit janar, sot mbushen 30 ditë pas përfundimit të tre mujorit do të thotë në afat ligjor.

Unë i kam analizuar disa pozicione dhe te të hyrat kam thënë se raportet edhe pse janë tre mujore, ato hartohen në raport me planifikimin vjetor. Nuk bëhet planifikimi i të hyrave sipas tre mujorëve. Si rast është te tatimi në pronë te tre mujori i tretë del që kemi një realizim 124%, kurse te tre mujori i fundit 69%. Kjo ndodh, sepse i kemi disa tre mujor ku kemi inkasim më të madh, prandaj e lus Drejtorinë e Buxhetit që në të ardhmen kjo të bëhet në raport me buxhetin e planifikuar. Nuk ka rëndësi a del tre mujori i parë 20-30%, sepse duhet të del në raport me të hyrat e përgjithshme dhe nuk bëhet planifikimi për tre muaj.

Te shpenzimet janë tri pasqyra nga të hyrat vetanake, nga grandi, donacionet, kurse në fund është pasqyra përmbledhëse për të gjitha këto. Kur t' i marrim dhe analizojmë këto shpenzime na del se të gjitha këto shpenzime janë në kuadër të planifikuarës ose me buxhetin e planifikuar. Në bazë të gjashtë mujorit e kemi parë se shpenzimet e krijuara dhe kur ia shtojmë edhe obligimet e pa kryera, mallrat dhe shërbimet mbi 98% janë shpenzuar me 6 mujor të tërë vitit. Për këtë arsyeje edhe te shpenzimet kapitale me 6 mujorin e viti 2013 jo që është shpenzuar i tërë buxheti, por janë krijuar edhe obligime edhe për këtë vit. Mirëpo ne të gjitha ato mund t' i shohim në mënyrë më detale, sepse këtu janë dhënë vetëm në mënyrë sintetike sipas organizatave buxhetore shpenzimet dhe jo edhe në mënyrë analitike sipas kodeve buxhetore etj. Është edhe raporti financiar i cili duhet të epet brenda afatit ligjor i cili sipas ligjit është 31 marsi, ku sipas ligjit do të paraqiten të gjitha shpenzimet edhe sipas organizatave buxhetore, sipas kategorive të shpenzimeve dhe kodeve buxhetore, por edhe obligimet të cilat janë krijuar në bazë të faturave të gjetura në drejtori, por edhe në bazë të detyrimeve kontingjente që janë kryer, por në të ardhmen kanë mbetur pa paguar, por nuk janë fatura të faturuara brenda sajë. Për këtë arsyeje propozova që kjo të jetë vetëm një informatë, kurse më detalisht do ta kemi rastin për të biseduar në kohën kur të bëhet raporti financiar.

Riad Rashiti- kërkoj që në raportin financiar sa i përket pjesës së shpenzimeve të paraqitura në raport do të duhej që të paraqitet planifikimi i shpenzimeve për secilën drejtori dhe për secilin kod. Ne këshilltarë shumica nuk kemi qasje dhe nuk e dimë sa ka qenë planifikimi i shpenzimeve për një sektor, departament ose kod buxhetor dhe shumën e atyre shpenzimeve. Nuk e kam të qartë sa kanë qenë të planifikuara dhe sa janë shpenzuar?

Tjetër është se dua ta di për obligimet e bartura ose borxhet e Komunës, sepse në çdo dy javë ndryshojnë shifrat të cilat shifra nuk janë të qëndrueshme, prandaj e shfrytëzoj rastin që të kërkoj nga zyrtari financiar që ta paraqes një raport financiar të datës 9.12.2013 të cilin e ka dorëzuar te ish kryetari i Komunës, sepse është një raport ku shihet se obligimet e Komunës nuk janë 8.5 milion siç del në opinion deklarata e kryetarit të Komunës, por janë 3 milion e 740 mijë i cili raport është dorëzuar nga zyrtari i cili tash është u.d së drejtorit të Buxhetit.

Është mirë që në seancën e radhës këto borxhe të dalin të dokumentuara dhe të dalin në KK dhe jo të bëhen deklarata të papërgjegjshme, sepse janë të dëmshme për imazhin e Komunës. Ne dimë që nga këto 3 milion e 700 mijë, 1 milion e 700 mijë € janë shpronësime të cilat janë për projektin e Lumit Mirusha. Për këtë projekt janë paguar nga buxheti i Komunës 1.1 milion €, kurse për ta përfunduar komplet këtë projekt janë të vlerësuara, jo të faturuara nuk janë ende obligime të Komunës së Gjilanit, sepse ato kanë procedura.

Mirëpo me rastin e marrjes së vendimit dhe shpalljes në gazetë zyrtare ato mund të llogariten si obligime e që shuma e tyre do të jetë 1 milion e 900 mijë €. Shumica e borxheve të bartura është te shpronësimet dhe te shpenzimet kapitale ku janë rrafsh 980 mijë €.

Kërkoj nga zyrtari financiar që të na sqarojë se a është raporti i dorëzuar në këtë datë i saktë?

Arben Mehmeti- pavarësisht raportit që e kemi në këtë seancë dhe nëse ka edhe gabime teknike dhe kryesuesja nuk ka qenë desh të lejojë që të vijnë këtu dokumente të cilat nuk janë në harmoni me rregullativën dhe që nesër mund të jenë problem edhe më i madh.

Rast konkret është ku thuhet: Raporti financiar korrik-shtator 2013, kurse më poshtë janar 2014. e kuptoj se këto janë gabime teknike, por duhet të mësohemi që mos të lejojmë këso gabime.

Mirëpo gabimi është edhe më i madh, sepse në fund këtij dokumenti është nënshkrimi i kryetarit aktual të Komunës së Gjilanit i cili nënshkrim nuk do të duhej të ishte, sepse kjo është një informatë dhe nëse ndokush vendos këtë raport për dërguar në organet e hetuesisë, së pari thirret kryetari aktual i cili nuk e ka asnjë përgjegjësi. Para Kuvendit duhet të mësohemi që të sjellim raporte serioze dhe mos të nënvlerësohet Kuvendit se gjëja ne nuk i kuptojmë dokumentet dhe nuk do të reagojmë çka do të na silltet.

Është rekomandim i imi se nënshkrimi i kryetarit aktual nuk duhet të figurojë në këtë raport financiar dhe të bëni përpjekje që në Kuvend të sillen dokumente serioze për debat. Të përmirësohen gabimet të cilat i thash më lartë, kurse kryetari aktual i Komunës nuk e ka përgjegjësinë për këto shpenzime! Ky raport ka qenë desh të nënshkruhet nga zyrtari për financa z. Ilmi Limani.

Në këtë raport ka mjaft gabime dhe parregullsi, por për këtë më gjerësisht do të debatojmë në raportin përfundimtar të vitit 2013.

Një vërejtje për sekretarinë, që në seancat e tjera të kujdeset ta rregullojë përkthimin simultan, sepse në këtë mënyrë si po bëhet përkthimi po pengohen anëtarët e Kuvendit.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi –kryetari e sqaroi se nuk ka përgjegjësi për këto raporte edhe pse është nënshkrimi i tij dhe i falënderoj të gjithë për kontributin dhe këshillat që u dhanë dhe fjalën përfundimtare për këtë informatë do ta ketë u.d. së drejtorit, zyrtar financiar në z. Ilmi Limani.

Ilmi Limani- në fillim e thash se raporti është bërë sipas nenit 2 të Ligjit për menaxhim të financave publike dhe e sqarova që shpenzimet paraqiten në momentin e pagesës dhe jo në momentin e ndodhjes.

Sa i përket asaj se pse shpenzimet kapitale janë shumë të mëdha është se Qeveria e Kosovës me dy vendime dhe me rishikim na ka ndarë buxhet shtesë mbi 2 milion 618 mijë €. Këtu janë paraqitur të dhënat shumë të sakta, kurse në raportin financiar do t' i japim të gjitha shifrat si të borxheve, shpenzimeve dhe detyrimeve.

Me këto debate, kjo informatë e buxhetit përfundoi dhe kryesuesja propozoi që të kalojmë në pikën të ndryshme.

Të ndryshme

Isa Agushi – së pari e përshëndes kryetarin e Komunës dhe të gjithë të tjerët, por fjalën e kërkoja për ta shprehur një shqetësim të banorëve të fshatit Zhegër, sepse hapësira në qendër të Zhegrës me sipërfaqe prej 24 ari, në të cilën sipërfaqe gjendet fusha e sportit

për shkollën fillore e cila deri në vitin 1955 ka qenë hapësirë e varrezave të fshatit. Mirëpo pas zhvendosjes së këtyre varrezave në lokacion tjetër ishte një vendim që kjo hapësirë të shfrytëzohet si objekt për grumbullimin e drithërave në kuadrin e Kooperativës Bujqësore e cila me vullnetin e qytetarëve është ndërtuar ky objekt. Edhe sot kjo depo është shumë pak e shfrytëzuar nga kooperativa si depo, kurse pas viteve të 80 këtë sipërfaqe e ka shfrytëzuar rinia e fshatit, sepse aty gjendet fusha e sportit, biblioteka dhe një paralele e mësimi parashkollor. Pas luftës ky objekt është shkatërruar në tërësi, por rregullimi i saj është bërë me ndihmën e disa dhuruesve të huaj si CDF e cila ka investuar 100 mijë €, po aq edhe Komuna e Gjilanit. Në vitin 1983 është bërë bartja e kësaj parcele në emër të Kooperativës Bujqësore edhe pse nuk kanë pasur qasje në këtë pronë.

Këtë bartje e ka bërë pushteti okupues i cili e ka udhëhequr atë fshat në atë periudhë. Për këtë arsyeje kërkojmë, që kjo hapësirë të mbetet për nevojat e banorëve të Zhegërës, sepse në afat sa më të shkurtër Zhegra do të jetë Komunë dhe duhet të jenë zyrat e Komunës në këtë objekt.

Banorët e Zhegërës janë të shqetësuar, sepse një komision nga AKP ka dalë në vizitë dhe sipas informatave ka tendencë për ta privatizuar këtë objekt.

Unë kërkoj që të jemi të kujdesshëm dhe ky Kuvend të merr masa për ta parandaluar privatizimin e këtij objekti.

Fehmi Sylejmani- pasi që jemi një përbërje e re e këtij Kuvendi edhe për nga mandati dhe përbërja e anëtarëve të Kuvendit, kërkojmë që të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të cilat janë në fuqi të na jepen si kopje fizike të gjithë anëtarëve të Kuvendit?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- rregulloret dhe Statutin e keni marrë, kurse të tjerat i keni në ueb faqe të Komunës.

Riad Rashiti- unë në fillim të seancës e ngrita një çështje, por kërkoj edhe njëherë të më jepen sqarime, sepse e dimë se një anëtar i Kuvendit nuk ka të drejtë t' i ketë dy pozita zyrtare. Është një anëtarë të Kuvendit nga radhët e LDK-së e cila i mban dy poste edhe pse kanë kaluar dy muaj nga konstituimi i Kuvendit. Do të duhej që kjo çështje të rregullohet dhe respektohet ligji.

Bujar Nevzadi- iu përshëndes dhe së pari kërkoj nga kryesuesja që të ma jep fjalën kur e kërkoj, sepse jam i interesuar që ky Kuvend të punojë mbarë dhe mirë dhe nuk dëshiroj që të përdorë mënyra të tjera për ta marrë fjalën.

E dyta ne kërkuam nga drejtori i Arsimit që nën të ndryshme ta njoftoj Kuvendin për incidentin në Gjimnaz, por unë nuk pajtohem me fjalën e drejtorit të Arsimit, por nuk do t' i them sot asnjë fjalë, sepse ai nuk është prezent, por do të flas në seancën tjetër.

Së treti nga kryetari i Komunës kërkoj që mos të na bërtas, sepse edhe ne jemi njerëz publik i njohim gjërat dhe jemi në Kuvend që një kohë të gjatë.

Mandej z.Zeka kërkoj sqarime nga Zyra Ligjore, e cila zyrë ka dhënë sqarime vazhdimisht për gjëra ligjore, prandaj unë jam që në këtë Kuvend të punohet mirë e mbarë dhe të sqarohen gjërat ashtu si duhet.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – ju si opozitë kërkuat nga drejtori i Arsimit vetëm një informatë e cila u dha nga drejtori, kurse ne nuk e debatuar më tepër, sepse komisioni disiplinor do të merret me atë çështje.

Arben Maliqi- unë e kam një kërkesë me rëndësi për Drejtorinë e Bujqësisë, sepse jemi në njohuri se fauna po shkatërrohet në mënyrë masive! Unë e di se janë tri shoqata të gjuetisë dhe janë edhe kryetarët e këtyre shoqatave, prandaj e lus drejtorin e Bujqësisë që të jetë në kontakt me këta njerëz dhe të bisedojë me gjuetarët dhe t' i respektojnë afatet kohore dhe ligjore për gjuajtje. Të merren masa të rrepta për shkelësit e ligjit dhe të dalin inspektorët natën në terren, sepse me të madhe janë duke dalë gjuetarët në gjuajtje të cilët përdorin metoda të vrazhdëta dhe po e shkatërrojnë faunën.

E lus drejtorin që të merr masa dhe ta ndal këtë shëmti e cila po ndodh me faunën tonë!

Nevzad Isufi- unë po bëj një pyetje për kryetarin dhe ajo është nëse ka mundësi ta dimë se cili është stafi i zyrës së tij? Ne e dimë se kjo zyrë e kryetarit ka qenë e mbingarkuar me staf, prandaj kërkoj që përafërsisht është mirë të informohemi për numrin e stafit të kryetarit?

Lutfi Haziri- sa i përket kërkesë së këshilltarit Isa Agushi, Ligji mbi privatizim lejon që prona me interes publik dhe iniciativë të Komunës, agjensioni e rishqyrton dhe deri më tash lista e kërkesave është shumë e kufizuar, por unë do të marrë veprim urgjent pas njoftimit që ekipi teknik i AKP-së ka qenë në një matje në terren në Zhegër për shkak të statusit që e ka pasur Kooperativa Bujqësore në Zhegër.

Ne si Kuvend do të marrim veprime konkrete, sepse Kuvendi e ka një rol të madh.

Këshilltarja komunale, znj. Florinë Jerliu është zgjedh është certifikuar nga KQZ-ja, është konfirmuar dhe betuar dhe asnjë iniciativë tjetër nga organet komunale nuk ka me vetë faktin që certifikohet nga organi kompetent, tregon qartë se kjo përveç konfliktit të interesit që e ka bërë, ne kemi kërkuar që Zyra Ligjore e MPL-së ta interpreton rolin dhe të ardhmen e Florinës si këshilltare.

Nuk ka qenë tendencë e imja për ta frikësuar askënd, pos asaj për të sqaruar gjendjen në Komunën tonë. Ne jemi njerëz që njihemi, kemi punuar bashkë një kohë të gjatë dhe do të punojmë bashkë. Asnjë tendencë nuk ka pasur tjetër, pos për të dhënë sqarime dhe do të mundohemi për të qenë sa më bashkëpunues.

Stafi kryetarit është Zyra Ligjore, Zyra e Prokurimit, Zyra e Personalet, Zyra e Projekteve, Avokati i Komunës, auditori në raste të veçanta etj.

Kërkesat dhe shkresat iu lus t' i bëni në mënyrë ligjore, sepse Kuvendit është i hapur edhe për publikun dhe nuk e kemi ndërmend ta kufizojmë askënd për të diskutuar.

Unë nuk kam asnjë staf tjetër, pos këtyre zyrave me të cilat takohem dy herë në javë dhe nuk kam asnjë staf tjetër që nga data 24 dhjetor kur e kam marrë detyrën.

Kontratat në vepra janë legale, por nuk janë të ligjshme, kur nuk ka buxhet. Kontratat në vepra kam kërkuar gjatë tranzicionit që z. Qemajl Mustafa t' i anulojë. Kjo ka ndodh dhe z. Mustafa i ka njoftuar të gjithë personelin ku ka kontratë në vepër për ta lëshuar vendin e punës, sepse pushojnë arsyet për të vazhduar me kontratë në vepër.

Kontratat profesionale (të ashtuquajtura profesionale dhe me shërbime profesionale) po ashtu janë mbingarkim për buxhetin dhe nuk mund të vazhdojmë t' i mbajmë 32 punëtorë e që janë dy kategori pagash e që i bie se njëra kategori se një asistente në QPS, merr më tepër pagë se shefi i sektorit të çështjeve sociale.

Kontratat e shpenzimeve dhe shërbimeve tjera, po ashtu janë të larta duke filluar nga kontrata për sigurim të objekteve e deri te kontrata më e vogël për blerjen e biletave.

Janë kontrata jashtëzakonisht të shtrenjta. Konkretisht në këtë raport gjendja është kështu, por për veprimet e tjera është duke u punuar shumë në shkurtimin e shpenzimeve për t' i mbuluar borxhet dhe obligimet që i kemi paraqit e që me ligj duhet të fillojmë t' i zbardhim dhe me ligj duhet të fillojmë për t' i paguar, por j obligimet në të cilat kemi gjet në të

cilat kemi gjet defekte ligjore, por jo edhe stafin i cili ka hyrë në punë me probleme ligjore dhe këtu i vihet pika çdo lloj referimi. Para ligjit nuk kemi nevojë të mendojmë, por kemi nevojë ta lexojmë dhe ta zbatojmë.

Më vjen keq, por gjendja është e tillë dhe dy problemet kryesore që i kemi duhet t' i zgjidhim me durim dhe solidaritet.

Nëse unë nuk po lejoj t' i marrë 30 punëtorë nga Zyra ime të cilët kanë qenë punëtorë të Komunës dhe gjendja tash është zero. Unë iu lus që ata 130 zyrtarë që duhet ta lirojnë Komunën nga mbingarkesa, duhet ta kuptojnë drejt se ky është vendim në përputhje me ligjin dhe me mundësitë buxhetore të cilat i kemi sot. Nëse Qeveria bindet që nesër t' i lejojë këto vende dhe nëse Qeveria e Kosovës, bindet për të na subvencionuar më tepër, unë jam i gatshëm për ta bërë rishikimin për pa e ndryshuar asnjë emër.

Asnjë emër nuk e ndryshojë në shërbim dhe do t' i thërras të gjithë dhe i fus në procedura të regrutimit dhe ia njoh të drejtën e konkurrimit me përparësi. Mirëpo kjo nuk ka ndodhur edhe pse unë e kam njoftuar MEF-in, MPL-në etj. Gjendja është e tillë, kush hynë në borxh ai duhet t' i likuideojë borxhet, ai që e bënë mbingarkesën, ai duhet ta bëjë shkarkesën! Unë e di që ky Kuvend është i nderuar, sepse i ka dy zv/ministra dhe dy zv/ministra duhet të shtronin autoritetin, politik dhe institucional për t' i zgjidh problemet gradualisht, sepse është interes i yni i përbashkët.

Bujar Nevzadi- nga ana e jonë e ke mbështetjen absolut për të ec për punë të mira, por të lus, sepse jemi lodhur në një kohë prej dy muajve me fjalë, prandaj tash fillo dhe fol me letra! Tetë milion borxh, na dokumento me letra! Të lus mos flisni më në ajër, por na dokumentoni me letra të gjitha ato që i thatë!

Lutfi Haziri- unë dy raportet në këtë Kuvend i kam sjell, sepse është kërkesë ligjore, por edhe raportin e ekzekutivit do ta keni. Po iu garantoj se dhe listën e stafit do ta keni edhe listën e borxheve do ta keni, gjithashtu edhe listën e kontratave të punës pa procedura do ta keni! Mandej do ta keni edhe listën e tejkalimeve, të gjitha do t' i keni, por duhet ta dini se një numër i madh i listave shkojnë në Prokurori. Mirëpo është e padrejtë për pa u njoftuar anëtarët e Kuvendit dhe autoritet e Komunës të procedojmë gjëra të mëtejme. Gjithçka që ligji do të kërkojë do të zbardhet.

Abdyl Aliu- në lidhje e kërkesën për transmetim të drejtpërdrejtë të seancës është një kërkesë e anës tjetër, kurse pak kohë më parë këtë e kemi kërkuar ne dhe na është thënë se nuk ka mundësi të bëhet ky transmetim. Mirëpo neni 68.4 i Ligjit të LVL e obligon KK-në për ta miratuar rregulloren komunale e cila promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative. Rregullorja e Komunës në nenin 14 dhe 15 e rregullon publicitetin e seancës. Neni 14 e rregullon çështjen se kur mund të jetë seanca e hapur dhe kur e mbyllur. Neni 15 e thotë se në pamundësi të transmetimit të drejtpërdrejtë të seancës, incizimi të vendoset në ueb faqe të Komunës. Në këtë aspekt ne si Kuvend jemi në kontinuitet të asaj që e kemi gjet nga qeverisja e kaluar. Sipas informatave që i kemi transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave bëhet në dy radio lokale dhe një tjetër epet si incizim me vonesë prej 30 minuta. Transmetimi i drejtpërdrejtë bëhet në Radio "STAR" dhe "VIKTORI". TV "Vali" e jep një incizim pas orës 18 të njëjtën ditë dhe sipas informatave jo zyrtare thuhet se një transmetim kushton afër 800€, kurse në radio 650€, jo sipas informatave zyrtare. Për një transmetim të drejtpërdrejtë, TV "Valit" i duhet për t' u pajis me teknikë, por edhe kostoja do të dyfishohet dhe do të jetë diku afër 1.700€. Unë mendoj se nuk do të pajtoheni që të bëhet një shpenzim aq i madh për një transmetim të drejtpërdrejtë, sepse e njëjta transmetohet të njëjtën ditë, por vetëm me pak vonesë.

Ne incizimin e TV “Vali” do ta postojmë në ueb faqe të Komunës, sepse kjo nuk sjell ndonjë shpenzim.

Nevzad Isufi- unë po pajtohem me z. Abdylin, por qyteti ka plotë pano dhe në kornizat e këtyre panove në qytet të futet edhe rendi i punës së seancave, sepse ne po thirremi në internet dhe mjete tjera elektorinike, por duhet menduar edhe për një kategori tjetër e cila nuk ka arrit në atë nivel për t’ i përvetësuar këto mjete. Unë besoj se shumë shpejtë qytetarët do të mësohen dhe do ta dinë se kur mbahet seanca e Kuvendit, kurse çmimi është vetëm një letër.

Labinotë Demi –Murtezi – unë e përshëndes kryetarin dhe zv/kryetarin, kolegët këshilltarë, kurse unë dua ta mbështesë kolegun Fehmi Sylejmani në mënyrë që të kemi dokumentacioni fizik, sepse gjatë seancave dhe para seancave na duhet që ta shpalosim dhe konsultojmë. Ndërsa sa i përket transmetimit të seancave nëse nuk mund ta bëjmë këtë për ta kursyer buxhetin, vendosja e transmetimit në ueb faqe të Komunës do të jetë mënyra më e lehtë dhe do të ishte minimumi që ne do të mund të bënim.

Do t’ i referohem edhe Arben Mehmetit se ka disa gabime drejtshkimore e sidomos mungojnë shenjat e pikësimit në shumë vende. Mirëpo sa i përket të dhënave janar, 2014 mungon një presje dhe pikë në fund, por nuk është drastikë, por nëse flasim për Lidhjen e Prizrenit dhe nëse flasim në cilin shekull është mbajt në fund duhet ta shkruajmë muajin dhe vitin në të cilin e kemi punuar atë punim seminarik.

Sahit Abazi – z. Abdyl Aliu e bëri një krahasim në mes partive, kur njëra ishte në pushtet, kurse tash në opozitë, por kjo parti e cila është në opozitë ka arrit që ta bëjë këtë transmetim, kurse tash i takon partisë tjetër e cila është në pushtet që këtë transmetim ta bëjë drejtpërdrejtë. Kjo nuk është e pakapshme, por është një veprim drejt transparencës.

Sa i përket pajisjeve teknike, me sa e dimë ne ekziston një mundësi e tillë ekziston, kurse çmimin e përcaktojnë procedurat tenderuese dhe nuk caktohet çmimi paraprakisht.

Kërkoj që nga seanca e ardhshme të shikohet mundësia e transmetimit të seancave në mënyrë të drejtpërdrejtë?

Me këto pika të rendit të punës seanca e tretë i përfundoi punimet në ora 11.45 minuta.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi